



UNIVERSITETI  
**BARLETI**

QENDRA E PERKUJDESIT PER  
TË MOSHUAR **“Te Moza”**

Nr. 372 prot, dt. 15/03 /2023

Nr. 01 prot, dt. 15/03 /2023

**MARRËVESHJE BASHKËPUNIMI**

**NDËRMJET**

**UNIVERSITETIT “BARLETI” DHE**

**QENDRES SE PERKUJDESIT PER TË MOSHUAR “Te Moza”**

**PËR**

**REALIZIMIN E PROJEKTEVE TË PËRBASHKËTA**

**Preambul:** Universiteti “BARLETI” (UniBa) dhe Qendra e Perkujdesjes per te Moshuar, “Te Moza“, në vijim të quajtura Palë:

Duke vlerësuar rëndësinë e përmirësimit të sistemit arsimor në kuadër të modernizimit të sistemit arsimor;

Duke marrë në konsiderate politikat e ndjekura dhe masat e ndërmarra për funksionimin dhe përmirësimin e një sistemi arsimor profesional të përgjegjshëm dhe modern për t’iu përshtatur kushteve të zhvillimeve sociale, në përmirësimin edhe të kushteve sociale dhe shërbimit social për moshën e tretë;

Duke inkurajuar angazhimin institucional për të siguruar standarde të larta në veprimtarinë dhe etikën e të gjitha hallkave të sistemit arsimor;

Duke konsideruar se një ndër objektivat kyçe në ushtrimin e veprimtarisë së sistemit arsimor është efikasiteti dhe efënca e administratës arsimore të këtij Universiteti në perputhje me standardet dhe praktikatat me të mira vendase dhe ato perëndimore;

Duke afirmuar vullnetin dhe vendosmërinë për të bashkepunuar dhe kontribuar në realizimin e qëllimit të kësaj Marrëveshje për të përmbushur edhe angazhimet në kuadër të Integritit Evropian të sistemit arsimor në fushën e shërbimit social;

Duke u mbështetur në kuadrin ligjor që rregullon veprimtarinë institucionale, konkretisht, në Ligjin nr. 80/2015, datë 22.07.2015, "*Per Arsimin e Lartë dhe kerkimin shkencor në institucionet e arsimit të lartë në Republikën e Shqipërisë*" dhe në Ligjin nr. Nr.10/107, datë 30.03.2009 "*Per kujdesin Shëndetsor në Republikën e Shqipërisë*";

Kanë rënë dakord të lidhin këtë Marrëveshje Bashkëpunimi, sipas termave të dakortesuara në vijim:

### **Neni 1**

#### **Objekti dhe qëllimi i bashkëpunimit**

1. Qëllimi kryesor i kësaj Marrëveshjeje është krijimi i një bashkëpunimi akademik, të posaçëm për kryerjen e veprimtarive të formimit profesional shkencor dhe praktik midis Universitetit "BARLETI" dhe Qendrës së Perkuajdesit për të Moshuar "*Te Moza*".
2. Bashkëpunimi ndërmjet dy institucioneve do të përfshijë:
  - a) *Nxitjen, mbështetjen dhe realizimin e projekteve të përbashkëta.*
  - b) *Shkëmbimin e ambjenteve të përbashkëta për orë laboratorike dhe ose praktika profesionale, zyra e mjedise të tjera në varësi të nevojave dhe mundësive të dy institucioneve.*
  - c) *Nxitjen, mbështetjen dhe realizimin e veprimtarive të tjera shkencore (konferenca, seminare e botime në fusha me interes të dyanshëm).*
  - c) *Punësimin eventual të studentëve.*

### **Neni 2**

#### **Dakortësia midis palëve**

Të dy institucionet bien dakort që realizimi i veprimtarive të mësipërme të kryhet në varësi të burimeve dhe potencialit të disponueshëm nga secili institucion. Detajimi i bashkëpunimit në fushat e mësipërme (1/a-d) dhe ndjekja e zbatimit do të realizohet nga një përfaqësues i caktuar nga secili institucion.

### **Neni 3**

#### **Organizimi i praktikave.**



- a) Numri i studentëve të praktikës jo më shumë se 6 (gjashtë) studentë.
- b) Periudha e praktikave jo më pak se 4 (katër) javë.
- c) Cdo student praktikant i pajisur me kartën e sigurimit shëndetësor, ligjit i sigurimit shëndetësor i studentit).
- d) Cdo student, i pajisur me uniformën e profesionistit dhe uniformen mbrojtëse: (doreza, kapuc, përparëse, maska, shapka).
- e) Student, vleresohet në fund të praktikës me një formular vleresimi e hartuar nga qendra “Te-Moza”.

#### Neni 4

#### Zgjidhja e mosmarrëveshjeve

Çdo nen i kësaj marrëveshje mund të ndryshohet, të amendohet ose të revokohet në cdo kohë pas një konsultimi dhe mirëkuptimi reciprok ndërmjet dy institucioneve.

#### Neni 5

#### Vlefshmëria e Marrëveshjes

Kjo marrëveshje është e vlefshme për një periudhë 3 vjeçare nga data e nënshkrimit. Ajo rinovohet automatikisht në mënyrë të heshtur, kur të dy institucionet janë dakort për këtë.

Nëse njëri prej institucioneve kërkon të zgjidhë këtë marrëveshje duhet të njoftojë me shkrim jo më pak se 3 (tre) muaj përpara. Mosrinovimi i kësaj marrëveshje bëhet nëpërmjet komunikimit zyrtar nga institucioni i interesuar të paktën 3 (tre) muaj përpara përfundimit të saj.

Kjo marrëveshje hartohet në 4 (katër) kopje, në gjuhën shqipe dhe tekstet e saj janë autentike.

Nënshkruar në Tiranë, në dt.     /     / 2023.

**UNIVERSITETI**

**QENDRA E PERKUJDESES PER TE MOSHUAR**

**“BARLETI”**

**“TE MOZA”**

**REKTORI**

**DREJTORI**

**PROF. DR. SUZANA GUXHOLLI**

**Msc. MIMOZA KALAJA**



*Mimoza Kalaja*  
**Msc. MIMOZA KALAJA**